



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës

NDËRMARRJA SHËRBIMEVE KOMUNALE Durrës

Nr. _____ prot

Durrës, më _____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Rroba Pune”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 18110000-3,
18130000-9

NUMRI I REFERENCËS SË PROCEDURËS: REF – 96362-08-17-2026

VLERA E FONDIT LIMIT: 5.827.666 (pesë milion e tetëqind e njëzet e shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa Tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja e Sherbimeve Komunale Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 26, nenit 27, 28, 29, 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë plotësohet nëpërmjet dorëzimit të Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2 në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

(Shënim: përcaktimi **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/b dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndersa në pikën 2/b citohet: vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, ndersa në pikën 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me

sukses kontraten. Gjithashtu vendosja e kriterëve në reference është bërë që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2/b, të Nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontraten.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar me Ligji nr. 16/2024, si dhe në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar, i cili rregullon kriteret për procedurat e hapura të thjeshtuara.

Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë përvojën e nevojshme për realizimin e kontratës. Për këtë arsye, është kërkuar që përvoja e mëparshme të

ngjashme të jenë në një vlerë jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit, në përputhje me kufijtë e përcaktuar në legjislacionin në fuqi. Përcaktimi i kësaj vlere është bërë në mënyrë proporcionale, duke marrë në konsideratë natyrën, përmasat dhe kompleksitetin e kontratës objekt prokurimi, me qëllim garantimin e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë që zotërojnë kapacitetin teknik dhe përvojën e nevojshme për realizimin e saj. Njëkohësisht, kjo kërkesë nuk tejkalon nivelin e nevojshëm dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi është vendosur brenda marzheve të lejuara nga legjislacioni përkatës dhe u jep mundësi pjesëmarrjeje një game të gjerë operatorësh ekonomikë. Në këtë mënyrë, kriteri për kontrata të ngjashme shërben si një instrument i rëndësishëm për vlerësimin e aftësisë teknike të operatorëve ekonomikë, duke garantuar një proces prokurimi të drejtë, transparent dhe efektiv.

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër dërgimin e mallit në adresat e përcaktuara të AK-ve.

3. Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të disponojë **të paktën 1(një)** automjet per transportin e mallrave, të cilin duhet t’i ketë në pronësi, me qira ose perdorim.

Per sa me siper operatori ekonomik ofertues te paraqes nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi ,ose qira, ose perdorim

Shenim 3.1: Per mjetet me status perdorimi qira ose hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarrësit.

Për këtë mjet duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve. Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin dokumentacionin e mesiperm prane Autoritetit Kontraktor jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit perfundimtar.

Ky kriter quhet i permbushur me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9, dhe ne baze të nenit 26, pika 6,

të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021, i ndryshuar, sipas të cilit: “6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike...”.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të cilat janë të nevojshme për transportin e materialeve të pastrimit në adresat e te gjitha autoriteteve kontraktore . Në zbatim të pikës 1 dhe pikës 6 të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “1.Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, ku përcaktohet “6. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin...”.

4. Operatori ekonomik ne lidhje me artikujt objekt prokurimi te percaktuar shtojcën 7 Formulari i sasisë dhe Grafiku i ekzekutimi, qe do te paraqese, duhet te plotësoje tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet te leshuara nga nje organ i akredituar.

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjinës	Certifikatë konformiteti ose cilësie /ekuivalent akredituar
1			
Etj.,			

Të dhënat që do të deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor për të genë pjesë e planit të zbatimit të kontratës. Rastet e deklaratave te rreme, do të konsiderohen kushte për skualifikim, si dhe do te ndiqet procedura per perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

5. OE duhet te paraqese ne SPE Autorizim prodhuesi ose Distributor i autorizuar nga prodhesei per mallrat e ofertuara. Ne rastet e autorizimit nga dristibutori, duhet te vertetohet lidhja qe distributori ka me prodhuesin. Ne autorizim duhet te jete i paraqitur Nr. i references se procedures

se prokurimit si dhe te dhena te sakta te Prodhuesit/Distributirit ne menyre qe AK te kete mundesi te kryej verifikimet e nevojshme.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standartit CE/ ose ekuivalent dhe direktivave lidhur si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi. Kërkesa që në autorizim të pasqyrohet numri i referencës së procedurës së prokurimit është e nevojshme dhe proporcionale, pasi garanton që autorizimi është lëshuar specifikisht për këtë procedurë prokurimi dhe jo një autorizim i përgjithshëm, i papërcaktuar apo i përdorur njëkohësisht në procedura të ndryshme.

Ky element i shërben autoritetit kontraktor që të verifikojë autenticitetin dhe vlefshmërinë e autorizimit; të sigurojë lidhjen direkte të prodhuesit/distributorit me procedurën konkrete të prokurimit; të shmangë paraqitjen e autorizimeve të përgjithshme, të pavlefshme ose të ripërdorura; të garantojë gjurmueshmërinë dhe transparencën e dokumentacionit të paraqitur; të krijojë mundësinë për kryerjen e verifikimeve administrative pranë prodhuesit/distributorit; garantimin e seriozitetit të ofertës dhe sigurimin e furnizimit me mallrat e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

6. Operatori Ekonomik duhet te paraqese ne SPE Deklarate ne te cilen te mare persiper permbushjen e specifikimeve teknike duke cilesuar per çdo produkt sipas kerkesave te AK si dhe realizimin e kontrates sipas afatit 20 ditor.

Argumentim: Ne baze te nenit 36 në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për tu siguruar nëse operatori ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas kerkesave dhe specifikimeve.

Afati 20 ditor per levrimin e mallit objekt prokurimi kerkohet sepse veshjet jane per cdo sezon dhe disa prej tyre perkojne me sezonin aktual.

7. Operatori ekonomik ofertues te paraqese certifikatat qe vërteton se sistemi i kontrollit të cilësisë së ofertuesit është sipas standartit.

- OE duhet te paraqese ne SPE Çertifikate personale ISO 9001:2015, te standartit nderkombetar te menaxhimit te cilesise dhe /ose te njevlefshme, te cilat do te garantonin cilesine e produktit ose standart ISO me e avancuar, ku te jete i percaktuar objekti i prokurimit (e perkthyer e noterizuar). Çerfikatat duhet te jene te vlefshme dhe te leshuar nga organizma te vleresimit te konformitetit, te cilet jane akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombetar akreditues të njohur nga Republika e Shqiperisë.
- OE duhet te paraqese ne SPE Çertifikatat e konformitetit per artikullin **Pelerine Shiu:**
 - Sipas normative; S.SH. EN ISO 13688:2013 ose version më i ri ekuivalent.
 - Sipas normative; SSH/ EN ISO 343:2019 CLASS 3: ose version më i ri ekuivalent,

- Sipas normative; S.SH. EN ISO 20471:2013 + A1:2016, Klasi 2 ose version më i ri ekuivalent.
- OE duhet te paraqese ne SPE Çertifikatat e konformitetit per artikullin **Xhup**:
 - Sipas normative; S.SH. EN ISO 13688:2013 ose version më i ri ekuivalent.
 - Sipas normative; SSH/ EN ISO 343:2019 CLASS 3: ose version më i ri ekuivalent,
 - Sipas normative; S.SH. EN ISO 20471:2013 + A1:2016, Klasi 2 ose version më i ri ekuivalent.
- OE duhet te paraqese ne SPE Çertifikatat e konformitetit per artikullin **Kepuce sigurie**:
 - Sipas normative; SSH/ EN ISO 20345:2022, S3, ose version më i ri ekuivalent,
- OE duhet te paraqese ne SPE Çertifikatat e konformitetit per artikullin **Pantallona+Xhakete**:
 - Sipas normative; S.SH. EN ISO 13688:2013 ose version më i ri ekuivalent.
 - Sipas normative; S.SH. EN ISO 20471:2013 + A1:2016, Klasi 2 ose version më i ri ekuivalent.
- OE duhet te paraqese ne SPE Çertifikatat e konformitetit per artikullin **Jelek fosforeshent**:
 - Sipas normative; S.SH. EN ISO 20471:2013 + A1:2016, Klasi 2 ose version më i ri ekuivalent.
- OE duhet te paraqese ne SPE Çertifikatat e konformitetit per artikullin **Bluze verore**:
 - Sipas normative; S.SH. EN ISO 13688:2013 ose version më i ri ekuivalent.
 - Sipas normative; S.SH. EN ISO 20471:2013 + A1:2016, Klasi 2 ose version më i ri ekuivalent
- OE duhet te paraqese ne SPE Çertifikatat e konformitetit per artikullin **Doreza sigurie**:
 - Sipas normative; SSH /EN 21420: 2020 ose version më i ri ekuivalent.
 - Sipas normative; SSH /EN 388: 2016+ A1:2018 ose version më i ri ekuivalent.
 - Sipas normative; SSH /EN ISO 10819:2013 + A1:2019 ose version më i ri ekuivalent.
- OE duhet te paraqese ne SPE Çertifikatat e konformitetit per artikullin **Doreza pune**:
 - Sipas normative; SSH /EN21420: 2020 ose version më i ri ekuivalent.
 - Sipas normative; SSH /EN388: 2016 +A1:2018 ose version më i ri ekuivalent.
- OE duhet te paraqese ne SPE Çertifikatat e konformitetit per artikullin **Çizme Llastiku** :
 - Sipas normative; SSH /EN ISO 20347:2022 ose version më i ri ekuivalent.

Argumentim: Kërkesat e mësipërme për paraqitjen e certifikatave të cilësisë, certifikatave të konformitetit dhe dokumenteve që dëshmojnë përmbushjen e standardeve teknike ndërkombëtare dhe evropiane, janë përcaktuar në funksion të natyrës, karakteristikave dhe destinacionit të produkteve objekt prokurimi. Në përputhje me nenin 40 dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, autoriteti kontraktor ka të drejtë të përcaktojë kërkesa për kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë, si dhe kërkesa teknike që lidhen me cilësinë, performancën dhe përputhshmërinë e mallrave objekt prokurimi, me qëllim garantimin e realizimit të kontratës sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Kërkesa për paraqitjen e certifikatës ISO 9001:2015 ose ekuivalente, me objekt të përcaktuar në përputhje me objektin e prokurimit, synon të garantojë se operatori ekonomik disponon një sistem

të dokumentuar të menaxhimit të cilësisë dhe procese të kontrolluara për sigurimin e cilësisë së produkteve që do të furnizohen. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me nevojën e autoritetit kontraktor për të siguruar që mallrat të jenë të një cilësie të qëndrueshme dhe të përmbushin specifikimet teknike të përcaktuara. Kërkesa që certifikatat të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituar nga DPA ose nga organizma ndërkombëtarë të akreditimit të njohur nga Republika e Shqipërisë, synon të sigurojë besueshmërinë, vlefshmërinë dhe verifikueshmërinë e dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Për sa i përket certifikatave të konformitetit të kërkuara për secilin produkt, këto kërkesa janë vendosur për të garantuar që mallrat e furnizuara të jenë në përputhje me standardet teknike të përcaktuara dhe të ofrojnë nivelin e nevojshëm të cilësisë, sigurisë, funksionalitetit dhe mbrojtjes gjatë përdorimit. Në mënyrë të veçantë, për pelerinat e shiut, xhupat, pantallonat + xhaketat dhe jelekët fosforeshentë, kërkesa për përputhshmëri me standardet SSH/EN ISO 13688, SSH/EN ISO 343 dhe SSH/EN ISO 20471, sipas klasifikimeve të përcaktuara në specifikimet teknike, lidhet me karakteristikat mbrojtëse të veshjeve, dukshmërinë e përdoruesit dhe mbrojtjen ndaj kushteve atmosferike. Për këto produkte është e rëndësishme që materialet dhe produkti përfundimtar të përmbushin kërkesat e përcaktuara për veshjet mbrojtëse dhe veshjet me dukshmëri të lartë. Për këpucët e sigurisë, kërkesa për përputhshmëri me SSH/EN ISO 20345:2022, S3, synon të sigurojë që këpucët e furnizuara të jenë të përshtatshme për përdorim si pajisje mbrojtëse personale dhe të ofrojnë nivelin e kërkuar të mbrojtjes në kushtet e punës për të cilat janë parashikuar. Për dorezat e sigurisë dhe dorezat e punës, kërkesat sipas SSH/EN ISO 21420:2020, SSH/EN 388:2016+A1:2018 dhe, për dorezat e sigurisë, SSH/EN ISO 10819:2013+A1:2019, lidhen me kërkesat e përgjithshme të dorezave mbrojtëse, mbrojtjen ndaj rreziqeve mekanike dhe, sipas rastit, mbrojtjen nga transmetimi i vibrimeve. Këto kërkesa janë të nevojshme për të siguruar që pajisjet mbrojtëse të jenë të përshtatshme për kushtet konkrete të përdorimit. Për produktin çizme llastiku, kërkesa për përputhshmëri me SSH/EN ISO 20347:2022 synon të garantojë që produkti të përmbushë kërkesat teknike dhe të sigurisë të aplikueshme për këpucët e punës, duke siguruar mbrojtjen dhe përshtatshmërinë e nevojshme gjatë përdorimit. Për bluzat verore, kërkesat sipas SSH/EN ISO 13688:2013 dhe SSH/EN ISO 20471:2013+A1:2016, Klasa 2, janë përcaktuar për të garantuar karakteristikat e nevojshme të veshjes dhe, në veçanti, dukshmërinë e përdoruesit në kushtet ku kjo është e domosdoshme për sigurinë në punë.

Në përcaktimin e këtyre kërkesave është mbajtur parasysh parimi i proporcionalitetit, pasi dokumentet e kërkuara lidhen drejtpërdrejt me karakteristikat, funksionin dhe përdorimin e mallrave objekt prokurimi. Kërkesat nuk synojnë favorizimin e një operatori ekonomik apo të një prodhuesi të caktuar, por verifikimin objektiv të cilësisë dhe konformitetit të produkteve që do të furnizohen. Gjithashtu, është përcaktuar se në rast se një operator ekonomik nuk disponon certifikata e konformitetit të sipërcituar i jepet mundësia e paraqitjes së versionit më të ri ose standardit ekuivalent, me qëllim që kërkesat teknike të mos kufizojnë konkurrencën dhe të

mundësojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që ofrojnë produkte të njëjta ose më të avancuara në aspektin e cilësisë, sigurisë dhe performancës.

Për rrjedhojë, kërkesat për certifikatat e cilësisë dhe certifikatat e konformitetit konsiderohen të nevojshme dhe të lidhura me objektin e kontratës, pasi i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të verifikuar paraprakisht se produktet e ofruara përmbushin kërkesat teknike, të sigurisë dhe të cilësisë të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe se furnizimi do të realizohet në përputhje me nevojat dhe qëllimin e prokurimit. Këto kërkesa mbështeten në nenin 40 dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në parimet e konkurrencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë, duke pranuar dokumente dhe standarde ekuivalente kur ato provojnë përmbushjen e të njëjtit nivel të kërkesave teknike dhe të sigurisë.

8. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë në SPE, Skeden Teknike për çdo mall që do prokurohet. Shenim: Për zerin nr. 7 (kapele) dhe zerin nr.11 (Perpearese) nuk është e nevojshme të paraqitet Skeden teknike.

Argumentim: Kërkesa që Operatori Ekonomik të paraqesë në SPE Skedat Teknike për çdo mall objekt prokurimi, sipas përcaktimit në dokumentet e tenderit, është vendosur në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së mallrave të ofruara me specifikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Skeda Teknike shërben si dokument provues nëpërmjet të cilit Autoriteti Kontraktor mund të identifikojë karakteristikat e produktit të ofertuar dhe të verifikojë përputhjen e tyre me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për artikujt e veshjeve të punës dhe pajisjeve mbrojtëse, për të cilët janë përcaktuar kërkesa të veçanta teknike dhe standarde të caktuara për cilësinë dhe sigurinë.

Paraqitja e Skedës Teknike krijon mundësinë që vlerësimi i ofertave të kryhet mbi bazën e të dhënave konkrete dhe të verifikueshme të produktit të ofertuar dhe jo vetëm mbi bazën e një deklarimi të përgjithshëm të operatorit ekonomik. Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe është përcaktuar në përputhje me parimin e proporcionalitetit, pasi dokumenti kërkohet për të provuar karakteristikat teknike të mallrave që do të furnizohen dhe për të garantuar përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike. Gjithashtu, kërkesa zbatohet në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë dhe nuk i referohet një marke, prodhuesi, origjine apo operatori ekonomik të caktuar. Për rrjedhojë, ajo nuk synon kufizimin e konkurrencës, por garantimin e një vlerësimi të barabartë dhe objektiv të ofertave.

Për sa më sipër, kërkesa për paraqitjen e Skedës Teknike për mallrat objekt prokurimi është e nevojshme dhe e arsyeshme për realizimin e një vlerësimi teknik të ofertave, për verifikimin e përputhshmërisë së produkteve të ofruara me specifikimet teknike dhe për garantimin që mallrat që do të furnizohen gjatë zbatimit të kontratës të përmbushin kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Ndërsa për zërin nr. 7 “Kapele” dhe zërin nr. 11 “Përparëse”, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar se nuk është e nevojshme paraqitja e Skedës Teknike. Ky përcaktim është bërë duke marrë në konsideratë natyrën, funksionin dhe destinacionin e këtyre artikujve, si dhe karakteristikat teknike të përcaktuara në specifikimet teknike të procedurës. Këto artikuj përdoren kryesisht si elementë të veshjes së punës dhe nuk kanë funksion të posaçëm mbrojtës apo sigurie, për të cilin të jetë e nevojshme kërkesa për certifikata specifike sigurie ose konformiteti, ndryshe nga pajisjet dhe veshjet mbrojtëse të parashikuara në artikujt e tjerë të procedurës.

9. Operatori ekonomik ofertues, në ditën e hapjes së ofertave (perpara hapjes së tyre), pranë Autoritetit Kontraktor, pranë NSHK Durrës, duhet të paraqesë të protokolluara një mostër për secilin ze të mallrave objekt prokurimi, sipas listës së kërkuar:

Tabela:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Pelerine shiu	Cope	1
2	Xhup	Cope	1
3	Kepuce sigurie	Pale	1
4	Pantallona+Xhaket	Pale	1
5	Jelek fosforeshent	Cope	1
6	Bluze verore me minge të shkurta	Cope	1
7	Kapele verore	Cope	1
8	Doreza sigurie	Pale	1
9	Doreza pune	Pale	1
10	Çizma Llastiku	Pale	1
11	Perparse pune	Cope	1

Shënim: Referuar udhëzimeve të APP, për zërat në DST që mund të jete paraqitur marke/brand, operatorët ekonomik mund të ofertojnë ekuivalente të tyre gjatë përgatitjes së ofertës ekonomike.

Shënim: Mosdorezimi i informacionit të saktë apo dorezimi të rreme do të konsiderohet kusht për skualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtim të O.E. nga procedurat e prokurimit.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, dhe veçanërisht në dispozitat që rregullojnë përcaktimin e kërkesave teknike dhe mënyrën e verifikimit të përmbushjes së tyre. Paraqitja e mostrës i mundëson Autoritetit Kontraktor të kryejë ekzaminimin dhe inspektimin fizik të produktit konkret të ofertuar dhe të verifikojë nëse ai përputhet me karakteristikat e kërkuara në specifikimet teknike.

Kërkesa për mostra është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e procedurës “Blerje rroba pune”, pasi artikujt objekt prokurimi janë produkte të cilat përdoren drejtpërdrejt nga punonjësit e ndërmarrjes gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Për këtë arsye, verifikimi vetëm nëpërmjet përshkrimeve të shkruara, katalogëve, fotografive apo deklarimeve të operatorëve ekonomikë nuk garanton në çdo rast mundësinë e vlerësimit të plotë të karakteristikave fizike dhe funksionale të produktit konkret të ofertuar. Në mënyrë të veçantë, paraqitja e mostrave është e nevojshme për të verifikuar, sipas natyrës së secilit artikull, materialin, cilësinë e përpunimit, ngjyrën, përmasat, konstruksionin, mënyrën e qepjes, elementët përbërës, elementët reflektues, funksionalitetin, përshtatshmërinë për përdorimin e synuar dhe karakteristikat e tjera të përcaktuara në specifikimet teknike.

Për “Pelerinën e shiut”, mostra është e nevojshme për të verifikuar materialin dhe karakteristikat e tij mbrojtëse ndaj reshjeve, cilësinë e përpunimit, qepjet, elementët e mbylljes, kapuçin, përmasat dhe karakteristikat e tjera të përcaktuara në specifikimet teknike.

Për “Xhupin”, mostra mundëson verifikimin fizik të materialit, cilësisë së përpunimit, konstruksionit, qepjeve, përmasave, elementëve të mbylljes, xhepave dhe karakteristikave të tjera të përcaktuara në specifikimet teknike, duke vlerësuar përshtatshmërinë e produktit për përdorim gjatë punës.

Për “Këpucët e sigurisë”, kërkesa për mostër lidhet me funksionin mbrojtës të këtij artikulli. Mostra mundëson verifikimin fizik të konstruksionit të këpucës, materialit, tabanit, elementeve mbrojtëse, cilësisë së përpunimit dhe karakteristikave të tjera të përcaktuara në specifikimet teknike dhe në dokumentacionin përkatës të konformitetit.

Për “Pantallona + Xhaketë”, mostra është e nevojshme për të verifikuar materialin, ngjyrën, përmasat, konstruksionin, cilësinë e qepjeve dhe përpunimit, xhepat, elementët reflektues dhe karakteristikat e tjera të përcaktuara në specifikimet teknike, duke mundësuar vlerësimin e kompletit si një produkt i përshtatshëm për përdorim gjatë punës.

Për “Jelekun fosforeshent”, mostra është e nevojshme veçanërisht për verifikimin e ngjyrës, dukshmërisë, vendosjes dhe konfigurimit të elementeve reflektuese, materialit, përmasave, mënyrës së mbylljes dhe karakteristikave të tjera të përcaktuara në specifikimet teknike, duke pasur parasysh funksionin e tij për rritjen e dukshmërisë së punonjësit.

Për “Bluzën verore me mëngë të shkurtra”, mostra mundëson verifikimin e materialit, ngjyrës, cilësisë së tekstilit, përmasave, qepjeve, përpunimit dhe elementeve reflektuese, si dhe të karakteristikave të tjera të përcaktuara në specifikimet teknike.

Për “Kapelet verore”, mostra është e nevojshme për verifikimin fizik të materialit, formës, përmasave, ngjyrës, cilësisë së përpunimit dhe elementeve të tjera të përcaktuara në specifikimet teknike, me qëllim që të sigurohet përputhshmëria e produktit konkret me kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Për “Dorezat e sigurisë”, paraqitja e mostrës është e nevojshme për shkak të funksionit mbrojtës të produktit dhe mundëson verifikimin e materialit, konstruksionit, cilësisë së përpunimit,

përshtatjes në dorë dhe elementeve të tjera të përcaktuara në specifikimet teknike, si dhe krahasimin e produktit fizik me dokumentacionin e konformitetit të paraqitur.

Për “Dorezat e punës”, mostra mundëson verifikimin e materialit, trashësisë, fleksibilitetit, konstruksionit, cilësisë së përpunimit, përshtatjes në dorë dhe karakteristikave të tjera funksionale të përcaktuara në specifikimet teknike, duke garantuar përshtatshmërinë e produktit për përdorimin e synuar.

Për “Çizmet e llastikut”, mostra është e nevojshme për të verifikuar materialin, konstruksionin, tabanin, përmasat, fleksibilitetin, cilësinë e përpunimit dhe karakteristikat e tjera të përcaktuara në specifikimet teknike, duke vlerësuar përshtatshmërinë e tyre për përdorim në kushtet e punës për të cilat janë parashikuar.

Për “Përparësen e punës”, mostra mundëson verifikimin e materialit, ngjyrës, përmasave, cilësisë së qepjeve dhe përpunimit, elementeve të lidhjes dhe karakteristikave të tjera të përcaktuara në specifikimet teknike, me qëllim garantimin e përshtatshmërisë së produktit për përdorimin e synuar.

Në tërësinë e saj, kërkesa për paraqitjen e mostrave synon që Autoriteti Kontraktor të mos kufizohet vetëm në informacionin deklarativ të operatorit ekonomik, por të ketë mundësi të verifikojë produktin konkret të ofertuar dhe përputhshmërinë e tij me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Mostrat shërbejnë si një mjet verifikimi të karakteristikave fizike dhe funksionale të produkteve dhe nuk zëvendësojnë certifikatat e konformitetit apo dokumentet e tjera të kërkuara në procedurë. Ato shërbejnë si një element shtesë për të garantuar që produkti konkret i paraqitur nga operatori ekonomik përputhet me produktin dhe karakteristikat e deklaruara në ofertë. Kërkesa është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën, funksionin, përdorimin dhe rëndësinë e secilit prej artikujve, si dhe nevojën e Autoritetit Kontraktor për të garantuar cilësinë, sigurinë, funksionalitetin dhe përshtatshmërinë e mallrave që do të furnizohen. Në këtë kuadër, paraqitja e mostrave është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, e nevojshme dhe proporcionale me qëllimin e prokurimit, zbatohet në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë dhe nuk synon favorizimin apo kufizimin e konkurrencës, por garantimin e një vlerësimi objektiv, transparent dhe të verifikueshëm të ofertave.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa për paraqitjen e mostrave për artikujt e përcaktuar në dokumentet e tenderit është e justifikuar teknikisht dhe juridikisht, pasi i shërben verifikimit të përputhshmërisë së produkteve të ofertuar me specifikimet teknike dhe garantimit të realizimit të kontratës në përputhje me nevojat dhe kërkesat e përcaktuara.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Specifikime

1. Pelerine shiu



- Pelerine shiu me shirita reflektive duke përdorur pëlhurë të lehtë, kjo pelerinë është plotësisht papërshkueshëm nga uji, gjithashtu përmban një kapuç të ambalazhuar, xhepa për ruajtje të sigurt, si dhe unaza dhe carje shpinën e pasme për të shtuar ajrosjen.
- Pëlhurë e lehtë ujëduruese me qepje të izoluar për të ndaluar penetrimin e ujit
- Qepje hermetike me shirit për mbrojtje më të madhe
- Shirit reflektues për më shumë dukshmëri
- Hapje me zinxhire para

- 2 xhepa për hapsirë të sigurtë
- Kapuç që paloset nën jakë
- Mëngë elastike nga Brenda
- Vrima dhe hapje mbrapa për ventilim dhe rehati
- Sipërfaqja e pëlhurës është ekstremisht ujë resistuese, duke e shpërndarë ujin nga sipërfaqja e pëlhurës.
- Të ketë logot e autoritetit para majtas, në shpinë dhe mëngën e majtë.
- Përmbajtja 100% Poliestër, e Veshur me PVC 210g
- Ngjyra/Fit/Size (verdhe pantone floreshente kodi PMS 380) / (jeshile pantone CMYK 362)Nr. S - 3XL
- Etiketa e firmes prodhuese të jete e trupezuar ku të jete të dallueshme Firma prodhuese dhe çertifikimit, për udhëzimin e përdorimit.
- Të stampuara me logon e institucionit

2. Xhup



- Copa e jashtme: pëlhurë poliestër Oxford WT-300D 3.1 me veshje PU, ose ekuivalente.
- Mbushja e brendshme: 100% poliestër HT-S-001, ose ekuivalente.
- Shiritat reflektues: material fosforeshent CSR-1303, D1001, 8906, ose ekuivalente.
- Fija e qepjes dhe e asamblimit: poliestër Oxford WT-300D 3.1 me veshje PU, ose ekuivalente.
- Material fluoreshent: WT-300D 3.1 poliestër oxford me PU, ngjyrë e (verdhe pantone floreshente kodi PMS 380)
- Materiali i pjesës së jashtme të kontrastit: WT-300D 3.1 poliestër oxford me PU ose ekuivalent.
- Materiali i pjesës së brendshme të kontrastit: tafta YS-P190T, ose ekuivalente.
- Xhup ngjyrë e (verdhe pantone floreshente kodi PMS 380) me shikueshmëri të lartë, pjesa e poshtme (jeshile pantone CMYK 362/blu e erret), Shirita fosforeshentë, 2 shirita horizontale, të gjerë 5 cm, të vendosur në pjesën e përparme dhe të pasme të trupit, me distancë ndërmjet tyre 30-35 cm, 2 shirita vertikale në supë, që bashkohen me ato horizontale, 2 shirita shtesë në secilin krah, të distancuar 31-33 cm nga njëri-tjetri. Kapuc i

integruar, i palosshëm, që mbyllet me velkro në pjesën e pasme të jakës, dhe që mund të shtrëngohet me kordon. Mbyllja e përparme: Me zinxhir dy drejtimesh në ngjyrë të (verdhe pantone floreshente kodi PMS 380), i mbuluar me bordurë 6-8 cm të gjerë, e mbyllur me 5 precina metalike, të vendosura 15-17 cm larg njëra-tjetrës. Xhepa: 2 xhepa të jashtëm me kapak, përmasa nga 19-21 cm gjerësi x 8-9 cm lartësi, 1 xhep i brendshëm në anën e majtë, me përmasa 15-17 cm gjerësi x 16-18 cm lartësi, me mbyllje me velkro. Mëngë të brendshme methurje elastike, me gjerësi 5-7 cm. Astari i brendshëm, qepur në formë rombesh. Jakë e lartë, me lartësi 14-16 cm.

- Etiketa e firmes prodhuese të jete e trpezuar ku të jete të dallueshme Firma prodhuese dhe çertifikimit, për udhëzimin e përdorimit.
- Të stampuara me logon e institucionit

3. Kepuce sigurie



Kepuce të mbrojtjes në punë, forme atlete pa qafe, me pore steelite S3 me linje speciale ajrosje, rezistente ndaj vajrave dhe hidrokarbureve. Rezistente ndaj rreshqitjeve. E veshur me material kunder goditjeve 200J, teknologjia PU dendesi e dyfishtë, antistatike dhe anatomike poliuretani i butë i mbuluar me pelhure absorbuese dhe me ajrosje me 3 shtresa për transferimin e lageshtisë në pjesën e jashtme dhe tharje të shpejtë, Përdorimi të jete të thjeshtë dhe këmbe të ndjehet komode gjatë përdorimit duke ruajtur anën shëndetsore të përdoruesit. Gjatë përdorimit të jete rezistent ndaj djersitjes të mbushura me material për rehati të kockave dhe kyçeve të këmbe. Mbyllja me lidhese. Lekure ujëduruese.

- Mbrojtësja e gishtave kompozitë për një mbrojtje maksimale (metal i integruar në kepuce)
- Shollë e mesme anti-shpim kompozitë me shtresë të butë PU
- Membranë 100% ujëdaluese
- Shollë anti-rreshkitje (SRC) për të parandaluar rrëshkitjen në qeramike dhe celik.
- Shollë rezistente ndaj vajrave
- Shuall me densitet të dyfishtë
- Përshtatje e gjerë
- Peshë e lehtë
- Rrjete ajrosese 3D
- Shiriti fosforeshent në pjesën e sipërme të thembrës
- Shtrese mbrojtëse TPU të gishtë për rezistencë më të lartë
- Lekurë e plotë me trashësi 1.8mm
- Ngjyra/Fit/Size
- Etiketa e firmes prodhuese të jete e trpezuar ku të jete të dallueshme Firma prodhuese çertifikimit dhe kodi i produktit.

4. Pantallona+Xhakete



Pantallona me dukshmeri te larte, 35% pambuk $\pm 10\%$, 65% polyester $\pm 10\%$, pesha 195 gr/m2 $\pm 10\%$, Ngjyre jeshile te kombinuar me te verdhe fluoreshente, me mbullje shirit floreshent tek pjesa e gjurit, xhepa perpara te pjerret dhe 1 xhep me kapak ne pjesen e siper gjurit ne anen e majte, dy shirita fosforeshente me dukshmeri te larte, 1 xhep ne pjesen pas, me bel me llasik me mundesi pershtatjeje.

Xhaketa me dukshmeri te larte, 35% pambuk $\pm 10\%$, 65% polyester $\pm 10\%$, pesha 195 gr/m2 $\pm 10\%$. Ngjyre jeshile te kombinuar me te verdhe fluoreshente, 2 xhepa perpara pllake me kapak dhe 2 xhepa siper me kapak te gjere dy shirita fosforeshente me dukshmeri te larte, sipas normativave te mbrojtjes dhe sigurise ne pune, Me logo te institucionit.

- Etiketa e firmes prodhuese te jete e trapezuar ku te jene te dallueshme Firma prodhuese dhe certifikimit,per udhezimin e perdorimit.
- Te stampuara me logon e institucionit

5. Jelek fosforeshent



Jelek material polyester 100% poliester, veshje pune fosforeshente me dukshmeri te larte, rezistente ndaj ujit dhe temperaturave te ulta, praktike profesionale me 2 shirita gri fosforeshente,.

- Etiketa e firmes prodhuese te jete e trapezuar ku te jene te dallueshme Firma prodhuese dhe certifikimit,per udhezimin e perdorimit.
- Te stampuara me logon e institucionit

6. Bluza verore me minge te shkurtra



- Bluze me mänge te shkurtra(polo), Perberja 100% poliester, pesha 150 g/m2 $\pm$ 10g.
- Polo teknike me mänge te shkurtra me shikushmeri te larte.
- Shirit fosforeshentë në pjesën e supeve dhe 2 shirita fosforeshent 5cm ne pjesen e barkut dhe kurrizit
- Jakë e sheshtë dhe mbyllje me 3 kopsa, të vendosura barazlarg nga njëra-tjetra.
- Jakë dhe skaje të mëngëve të thurura me thurje të sheshtë.
- Ngjyra e jakes me te njejen ngjyre me pjesen e poshtme te bluzes.
- Menget dhe siper gjoksit e verdhe(verdhe pantone floreshente kodi PMS 380),pjesa poshte gjoksit jeshile (jeshile pantone CMYK 362) me dy shirita fosforeshent me shikushmeri te larte. Pelhure e rehatshme e perzier ne polyester dhe pambuk per me shume rehati.
- Etiketa e firmes prodhuese te jete e trupezuar ku te jene te dallueshme Firma prodhuese dhe çertifikimit,per udhezimin e perdorimit.
- Te stampuara me logon e institucionit

7. Kapele verore



Kapele ngjyra (jeshile pantone CMYK 362) , masa 160 gr/m2 $\pm$ 10%, trashesia 0.5mm, qendrueshmeria e ngjyres Nota 5, ,ne pjesen ballore te jete e stampuar logo

- Te stampuara me logon e institucionit

8. Doreza sigurie



Mbështjellje polietileni me performancë të lartë. Përforcimi TPR(Thermo Plastic Rubber) në shpinë dhe në majë të gishtave. Materiali kryesor për dorezat e mbrojtjes nga goditja është TPR (Gome Plastike Termike). Elasticiteti i gomës e bën atë zgjedhjen ideale për sigurimin e mbrojtjes së dorës, ndërsa gjithashtu ofron fleksibilitet të plotë dhe lirshmeri të lëvizjes. Me veshje nitrili në pëllëmbë dhe në majë të gishtave. Përforcimi i brendshëm i stampuar në pëllëmbë. E veshur me një shtresë akrilik nga brenda. Fije Kevlar në të gjitha shtresat.

- Rezistenca ndaj konsumimit)
Rezistenca ndaj prerjes
- Rezistenca ndaj grisjes
- Rezistenca ndaj shpimit
- Etiketa e firmes prodhuese të jete e trupezuar ku të jete të dallueshme Firma prodhuese dhe çertifikimit, për udhëzimin e përdorimit.

9. Doreza pune



Doreza pune për grumbulluesit e mbeturinave me përzierje 35% pamuk+35% poliestër +30% poliuretani Trashësi 0.6-0.8 mm Qendrueshmëri e ngjyres Nota 4; masa 300 gr/m². Pjesa e jashtme e pëllëmbës së dorës dhe e gishtave të jete e gomuar, pjesa e brendshme dhe ajo e jashtme beze pamuku. Të kenë gjatësi deri në kyç me gjatësi 6 cm me përzierje pamuk i thurur elastik.

- Etiketa e firmes prodhuese të jete e trupezuar ku të jete të dallueshme Firma prodhuese dhe çertifikimit, për udhëzimin e përdorimit.

10. Çizme llastiku



Çizme gome me ngjyrë **blu ose jeshile** me përbërje 100% polivinil klorid (PVC). Astari i brendshëm: poliestër i bardhë me thurje, gjatësia e çizmes deri poshtë kupës së gjurit, e padepërtueshme nga uji, vaji, me shollë me lule. Lartësia e çizmes duhet të jetë 33 (në varesi të masës). Të rezistojnë ndryshimit të temperaturës së ambientit të punës. Të jete të përshtatshme për të

punuar ne ambiente me prezence te vajrave lubrifikante, karburanteve, etj. Ngjyra e çizmeve te jete blu ose jeshile Cilesia e larte. Prodhimi i çizmeve te jete bere jo me pare se nje vit nga koha e levrimet.

- Etiketa e firmes prodhuese te jete e trupezuar ku te jene te dallueshme Firma prodhuese dhe çertifikimi.

11.Perparese Pune



Materiali 35% pambuk dhe 65% poliester,tekstil i tezgjahur,pesha 245gr/m2± 10,methurje sarzh 2/1,cilesia e larte. Te kete jake ngjyre e verdhe(verdhe pantone floreshente kodi PMS 380) hapje para dhe mbërthimi me percina ne forme unaze me gjersi 1 cm. Ne pjesen e perparme te saj te kete dy xhepa dopjo pllak dhe siper nje xhep ne krahun e majte. Bluzat te jene me minge te gjata. Ne xhepin e majte lart dhe ne pjesen e kurriz te stampohet logoja e ndermarrjes.

Ngjyra: (jeshile pantone CMYK 362).

Ne te gjitha Veshjet ne pjesen e kurrizit do te stampohet Logo e Ndermarrjes si meposhte:



BASHKIA DURRES

NSHK

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar., duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet Teknike gjenden ne shtojcen 6 te Dokumentave Standarte te Tenderit.

Argumentimi teknik: Specifikimet teknike për rrobat e punës objekt prokurimi janë hartuar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi për prokurimin publik, duke respektuar parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit. Ato janë konceptuar duke përshkruar minimumin e kërkesave të nevojshme teknike dhe funksionale që duhet të përmbushin rrobat, me qëllim garantimin e cilësisë, qëndrueshmërisë dhe komoditetit në përdorim.

Përcaktimi i këtyre kërkesave është bërë në mënyrë të argumentuar, duke u bazuar në nevojat konkrete të autoritetit kontraktor dhe në natyrën e veprimtarisë së tij në fushën e shërbimeve të pastrimit, ku përdorimi i rrobave të përshtatshme dhe funksionale është thelbësor për realizimin efektiv dhe të sigurt të detyrave. Në këtë kuadër, kërkesat teknike janë orientuar drejt sigurimit të rrobave të punës të përshtatshme për përdorim të përditshëm dhe intensiv, me materiale rezistente ndaj konsumimit dhe larjeve të shpeshta, me ajrosje të mirë, duke garantuar njëkohësisht edhe sigurinë dhe komoditetin e punonjësve gjatë përdorimit.

Çdo kërkesë e përcaktuar në specifikimet teknike lidhet drejtpërdrejt me funksionin që duhet të përmbushin rrobat dhe nuk tejkalon nivelin e nevojshëm për realizimin e qëllimit të kontratës, në respektim të parimit të proporcionalitetit. Njëkohësisht, specifikimet janë hartuar në mënyrë të tillë që të mos kufizojnë konkurrencën, pasi nuk përmbajnë referenca ndaj markave tregtare, prodhuesve të caktuar, origjinës apo proceseve specifike të prodhimit.

Në rastet kur janë përdorur standarde teknike, ato janë shoqëruar me shprehjen “ose ekuivalente”, duke garantuar mundësinë për pjesëmarrje të gjerë të operatorëve ekonomikë dhe ofrimin e produkteve alternative që përmbushin të njëjtin nivel cilësie, sigurie dhe performance.

Në këtë mënyrë, specifikimet teknike për rrobat e punës shërbejnë si një instrument i domosdoshëm për garantimin e një procesi prokurimi efektiv dhe të drejtë, duke siguruar përmbushjen e nevojave të autoritetit kontraktor pa cenuar parimet bazë të konkurrencës së lirë.